



Nr. 19/2 prot
Shkodër 14/06/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 10 Datë 07.03.2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT
UJORE PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT "BRERA" SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V e n d o s i:

- 1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit "**BRERA**" SH.P.K me administrator Z. Madi SELIMI, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Gramës**, degë e Lumit Drin, për prodhim energjie elektrike (HEC BLLICË) në fshatin Bllicë, Njësia Administrative Fushë Çidhën, Bashkia Dibër, Qarku Dibër.
- 2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:
 - Shkatërron mjedisin dhe turizmin
 - Vështirësonte jetën sociale dhe ekonomike të banorëve me cënimin e ujit të pijshëm dhe ujit për nevojat e bujqësisë në zonë.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

